



PROCESVERBAL VII/2023

I mbajtur me rastin e mbledhjes së VII(shtatë) për vitin 2023 të Komitetit për
Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 20.07.2023
Ora : 13:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues

*z. Urim Suka
znj.Bulëza Kuçi
znj.Fidaije Kukaj
znj.Sanie Kuçi Rexhepaj
z.Dardan Berisha
z.Liridon Fandaj*

Të pranishëm tjerë:

Nënkryetarja e Komunës znj.Mihrije Suka

Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullore për ndarjen e subvencioneve ;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ti ndihmuar klubit të futbollit “Ballkani” me seli në Suharekë;**
- 4. Shqyrtimi i raportit financiar i administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar - qershor 2023;**
- 5. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Suharekës për vitin 2022;**
- 6. Informatë për aktivitetet e KKSBB-së për periudhën janar - qershor 2023;**

Kryesuesi - është kërkesë e ekzekutivit të futet një pikë shtesë në rend dite e cila është bartja e mjeteve. I pranishëm është ZKF i cili mund të jep sqarime sa i përket kësaj pike shtesë.

Urim Suka - sot kemi tema shumë të rëndësishme për të diskutuar dhe asnjëri prej drejtorave nuk është i pranishëm për të na dhënë sqarimet e nevojshme.

Dardan Berisha - a është e obligueshme me qenë prezent drejtorat sikurse ne anëtarët e KPF-së?

Kryesuesi - nuk e di a është e obligueshme por për deri sa njoftohen për takimin besoj që duhet të jenë prezent.

Avni Bytyqi - propozuesit e pikave janë të obliguar me ardhë.

Liridon Fandaj - nëse është raporti i auditimit dhe nuk është Drejtori i Financave prezent për t'na dhënë sqarime, atëherë ne nuk kemi çka me diskutu.

Fadil Hoxha - ZKF jep sqarime sa i përket bartjes së mjeteve dhe thotë të hyrat vetanake të viti 2022 janë aprovu mbledhjen e fundit. Me datë 7 qershor e kam dërgu në thesar. Me datë 18.07.2023 ka ardhë një shkresë prej Ministrisë ku thuhet: kërkesa për bartjen e të hyrave vetanake është shqyrtuar por nuk mund të procedohet për arsye se ka ndryshim në strukturën e shpenzimeve. Unë kam kërku sqarime nga zyrtari atje se ku është bërë ndryshimi por nuk kam marrë sqarime. Në konsultim me Kryetarin e kemi sjell këtë listë. Subvencionet janë hek, ku kanë qenë: 40.000 te Drejtoria e Financave dhe 42.000 te Drejtoria e Bujqësisë dhe këto 82.000 janë bartë te projekti i varrezave të qytetit. Janë zvogëlu mallrat dhe shërbimet prej 32.000 në 15.000, janë rrit komunalit prej 5.000 në 11.000. Është në dorën tuaj nëse doni ta dërgoni për Asamble.

Urim Suka - unë nuk kuptova.

Fadil Hoxha - jep sqarime dhe një herë.

Liridon Fandaj - a janë në përputhje këto bartjet me ato që janë planifiku?

Fadil Hoxha - po.

Liridon Fandaj - çdo herë po bëjmë ne bartje nëse janë projekte afatgjate por nuk janë të planifikune për 2022-tën. P.sh. projekti i varrezave është 1.200.000 por i kemi nda këtë vit 500.000. Nëse e bëjmë këtë bartje, ne i kemi planifiku 500.000.

Fadil Hoxha - këto projekte janë projekte dy vjeçare.Për vitin 2024 ende nuk e kemi kry buxhetin dhe tani vje qarkorja e dytë.ZKF tutje jep sqarime.

Liridon Fandaj - mos të planifikojmë diçka që prap ka me u kthy.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën shtesë për rend dite.

6 për,1 apstenim
Miratohet pika shtesë

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës me pikën shtesë.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullore për ndarjen e subvencioneve ;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - për mua është jo serioze mos prezenca e Drejtoreshës sepse nuk i kemi sqarimet që na duhen.A është krejt rregullorja apo vetëm pjesa ku ndryshon?

Avni Bytyqi - është vetëm pjesa e ndryshimit.

Urim Suka - ka qenë mirë ta kemi rregulloren paraprake në mënyrë që ta dimë si ka qenë dhe si po bëhet.

Avni Bytyqi - me kërkesë të drejtorisë së Kulturës,Kryetari e ka formu grupin punues ku unë kam qenë kryesues i grupit punues dhe kemi ardhë në përfundim që kjo rregullore të bëhet vetëm sipas kërkesës së Drejtorisë së Kulturës. I kemi specifiku se cilat fusha ka të drejtë Drejtoria e Kulturës ti subvencionojë krahas rregullores 04/2017 që i subvencionon OJQ-të dhe kemi ardhë në përfundim që në kuadër të rregullores të vitit 2013 ti fusim edhe 3 apo 4 nene shtesë të cilat e bëjnë sa më transparente rregulloren e vitit 2013.Zyrtari ligjor tuje jep sqarime.

Urim Suka - raportet kthyesë që ju i keni specifiku këtu dhe që po thoni që këto janë ndryshimet që nuk i ka pas rregullorja më herët,unë besoj që kanë qenë edhe më herët raportet kthyesë sipas ligjit dhe duke e llogarit edhe raportin e auditorit që e kam pa.Mirë që po vendoset tash sepse është me rëndësi.Pjesë tjetër e mirë është edhe monitorimi.A kemi të drejtë çdo klub sportiv me subvencionu?

Avni Bytyqi - klubet sportive që janë klube private,me këtë rregullore mund ti subvencionojmë.

Rregullorja e Qeverisë 04/2017 i subvencionon vetëm OJQ-të. Klubet sportive që janë të themeluara si OJQ,ato duhet ti nënshtrohen procedurave që janë të parapara me rregulloren 04/2017 të Republikës së Kosovës. Është një dispozitë ligjore që kemi të drejtë me i subvencionu edhe klubet tjera apo njerëz ose OJQ të cilat nuk e kalojnë vlerën 500€.Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Dardan Berisha - mos ka ndonjë shpërputhje me pikën 3 ?Sepse ne një herë te pika 3 i kemi ndihmu klubit të futbollit “Ballkani” ?

Avni Bytyqi - nëse ka,nuk do e kishim vendos ne në rregullore.

Liridon Fandaj - kush ka qenë në komision për formimin e kësaj rregullore.

Avni Bytyqi - me vendim të kryetarit kam qenë unë kryesues i komisionit,Drejtoresha Lorika Gashi dhe Suada Berisha.

Liridon Fandaj - në këtë rregullore është dasht me u konsultu edhe me ministrinë,me hy edhe raporti financiar.Çdo OJQ dhe çdo biznes është i obliguar me raportu në këshill për raportim financiar.Kjo rregullore nëse formulohet tash,është mirë me pas parasysh edhe këto,që nesër mos me ardhë ne në Asamble me marrë marrë një vendim për ndarjen e subvencioneve e me qenë ato subvencione të kundërligjshme.

Avni Bytyqi - për Asamble ka me ardhë edhe rregullorja aktuale që është dhe në kuadër të rregullores të vitit 2013 është që Kryetari i Komunës ka kompetencë dhe autoritet deri në 3.000€ me nda për persona fizik ndërsa deri në vlerën 5.000€ për persona juridik ndërsa vlera e cila kalon mbi 5.000€, gjithmonë kompetenca i delegohet Kuvendit. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Urim Suka - a ka thirrje publike?

Avni Bytyqi - për personat juridik me thirrje publike ndërsa për personat fizikë pa thirrje publike. Shumë shpejt Drejtoria e financave do ta bëjë subvencionimin e bizneseve që udhëheqen nga gratë ku do ti përmbahen disa rregullave dhe disa procedura që i parasheh edhe rregullorja dhe thirrja publike.

Urim Suka - me thirrje publike, a ka të drejtë me i kalu 5.000€? Në shumë raste është kalu.

Kryesuesi - kjo është bërë te kultura.

Avni Bytyqi - jo, nuk ka të drejtë. Për OJQ-të është rregullorja e Qeverisë, Ministrisë së Financave 04/2017 që i rregullon procedurat. Për subjektet juridike, për bizneset, ajo nuk vje në shprehje por është kjo rregullore e subvencioneve.

Nënkryetarja - subvencionimi te zyra Kryetartit dhe te Drejtoria e Kulturës, dallon. Vlera maksimale ka qenë 1.000€ kur Kryetari ia ka nda sidomos rasteve me sëmundje të rënda.

Liridon Fandaj - ju jeni tu e kriju një presedentë që çdo njeri që ekziston në Suharekë mundet me qel një klub privat edhe me ardhë me marrë pare në Komunë.

Urim Suka - sa i përket rregullores, duhet të na vje rregullorja që ka qenë dhe ky material, pastaj ne i krahasojmë dhe përgatitemi për Asamble.

Dardan Berisha - komplet subvencione janë 100.000. Si po i shpërndani? Kemi mundësi çdo njërit me i ndihmu prej klubeve, sporteve të dalluara, grupeve. Të hartohet një rregullore më e mirëfilltë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

4 për, 2 kundër, 1 abstenim
Miratohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ti ndihmuar klubit të futbollit “Ballkani” me seli në Suharekë;

Kryesuesi - e elaboron pikën 3 dhe hap debatin.

Liridon Fandaj - nëse në rregullore nuk parashihet dhe është deri në 5.000€ me i subvencionu këto, atëherë në bazë të cilit ligj bazoheni? Ju po thirrreni në ligjin për financat publike. Ku bazohemi ne? Ky e ka në shfrytëzim stadiumin dhe ka të hyra nga ai stadium por asnjëherë, asnjë raport nuk na ka ardhë në KPF apo në Kuvend. Ku po shkojnë ato mjete që i inkason ai? Ato taksa ne po i ndajmë e po ia japim këtij si biznes.

Kryesuesi - unë e lexova kërkesën e tyre dhe arsyen pse po i ndajmë këto mjete. Sa i përket stadiumit, është bërë një thirrje publike për me dhënë në shfrytëzim Komuna, ai ka apliku dhe e ka marrë në shfrytëzim për 10 vite.

Liridon Fandaj - nuk e di çfarë të mire përfiton Komuna nga ky biznes!

Kryesuesi - Komuna jo por komuniteti i Suharekës po. Është një krenari.

Urim Suka - ne jemi përball edhe herë të tjera me një situatë të tillë. Me këto vendime që po i marrim duke i përkrah njëanshëm, është jo serioze. Edhe neve po na qitni në lajthitje. A kemi të drejtë që ta bëjmë një rregullore e cila e përcakton që klubi i cili shpallet kampion ta subvencionojmë, kuptohet mbi bazën e nivelit të garave. Ti e stimulon që të bëhen ata kampion dhe jemi të barabartë për të gjithë. 80.000 ia kemi nda vjet, 80.000 parëvjet, 40.000 sivjet e të tjerëve kurrë ose ata le t'vin me thirrje publike. Edhe këtu ta bëjmë me thirrje publike.

Avni Bytyqi - përfaqësia e klubit të Ballkanit është sepse është klub privat dhe nuk është OJQ. Nëse do të ishte OJQ, është dasht ti nënshtrohet procedurave sikur që iu kanë nënshtro të gjitha klubet tjera sportive sipas rregullores 04/2017 për subvencionimin e OJQ-ve. A kemi bazë ligjore? Të gjitha çështjet tjera të cilat nuk i rregullojnë ligjet bazike, mbetet në kompetencën dhe mandatin e Kuvendit që ti rregullon përmes akteve normative që miratohen në Kuvend. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Sanie Kuçi Rexhepaj - kërkesa është bërë për fazën përgatitore por unë sa e di lojrat vetëm kanë fillu. Kjo po bie ndesh me kërkesën dhe arsyeshmërinë e klubit. Monitorimi dhe raportimi që u diskutu në pikën paraprake nuk po ka sens në këtë pikë që e ka kërku klubi.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

4 për,3 kundër
Miratohet pika 3

Pika 4. Shqyrtimi i raportit financiar i administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar - qershor 2023;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - kur jemi te shqyrtimi i raportit për shpenzimet e buxhetit për 6 mujorin, këtu po del që janë shpenzu vetëm 3% dhe ne s'kemi çka me shqyrtu këtu. Shumica e drejtorive për telefoni mobile më pak mjete kanë shpenzu ndërsa drejtoria e Bujqësisë ka shpenzu 1.100€ për 6 muaj. Dua të di çka është më specifike që kjo drejtori ka shpenzu më shumë?

Kryesuesi - në momentin kur e bën thirrjen publike për grandin qeveritar, ai ka shumë thirrje dhe kur ti shpërndan ato prap ka ankesa. Mirë do të ishte të ishte këtu për sqarime por është në pushim vjetor.

Urim Suka - për veq që keni 3% investime kapitale, ku është problemi me Kolektorin që nuk po fillon? Ku është problemi me varrezat që janë ndërpre punimet? Ku është problemi me shtëpinë e Kulturës?

Kryesuesi - ndonjëherë firmat ankohen mes vete dhe lëndët shkojnë në OSHP dhe shtëpia e Kulturës pikërisht për këtë ka mbet kështu. Kolektori do të fillojë në shtator.

Labinot Halitjaha - Urim nuk janë 3% por 8% te investimet kapitale. Ju e dini që buxheti në tre mujorin e parë nuk shfrytëzohet. Këtë vit ju e dini që pjesa më e madhe e kohës ka qenë shi. Ka shumë lëndë kur ankohen kompanitë dhe lëndët shkojnë në OSHP dhe fajet nuk janë te ne.

Liridon Fandaj - çka nënkuptohet me drekat zyrtare dhe jo zyrtare?

Nënkryetarja - te drekat jo zyrtare, ju e dini që ne i kemi edhe qerdhet dhe paguhen përmes kësaj.

Liridon Fandaj - nëse paguhen, a paguhen prej zyrës së Kryetarit? Në bazë të drekave zyrtare dhe jo zyrtare, del që 2.000€ në nuaj i ka shpenzu për dreka.

Nënkryetarja - prej zyrës së Kryetarit ne e kemi një mekanizëm kundër dhunës në familje ku mbahen 4 takime në vit dhe i cili është i përbërë prej 14 anëtarëve. Pas atij takimi shtrohet një drekë. Kemi komisionin për ndryshim të tarifave, grave të dëshmorëve ia shtrojmë një drekë, pastaj është një fond prej 1.000€ për policinë që e subvencionojmë për çështjen e dhunës në familje. Nënkryetarja tutje jep sqarime.

Liridon Fandaj - te Kuvendi Komunal- shërbime të ndryshme intelektuale. Pse 2.600€?

Avni Bytyqi - janë komisione që janë formu nga Kuvendi, konkretisht KKSBB ku paguhen 6 apo 7 anëtar nga 50 €. Pastaj janë komisionet tjera që themelohen nga Kuvendi dhe që paguhen nga 50€.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

4 për,1 kundër,2 apstenime
Miratohet pika 4

Pika 5. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Suharekës për vitin 2022;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin

Urim Suka - është obligim i joni me trajtu raportin dhe me dërgu në Kuvend. Jam pak a shumë i çuditur. Sigurisht që raporti i merr disa mostra dhe nuk mund të shoh krejt çka ka ndodh por kjo kronologji e raportit është mirë me ndryshu sepse shihet që ka gabime, gjetje plot por nuk e trajton problemin në thelb. P.sh. përmendet projekti i ndërtimit në rrugën lokale në Mushtisht në vlerë prej

72.000€,mungon projekti ekzekutiv por këtu në realitet asnjëra rrugë nuk është shtru.Pika tjetër thotë: pagesa e projekteve nga buxheti i projekteve tjera.Më shumë se gjysma e projektit është deviju dhe këtu mjaftohet me kaq.Ka edhe shumë gjetje tjera të cilat do ti adresojmë edhe në Asamble.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5.

Unanimisht Miratohet

Pika 6. Informatë për aktivitetet e KKSBB-së për periudhën janar - qershor 2023;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - krahasimin kur e keni bërë te mbledhja e parë thuhet që zbulueshmëria e rasteve të vjedhjeve është 78%.A është e bazuar në situata reale apo po dojmë me kthi në një raport me pozitivitet?

Avni Bytyqi - situata është reale sepse komandanti i policisë ka raportu për këtë çështje dhe përpos që raporton te ne,raporton edhe në ministri.

Urim Suka - disa vjedhje që kanë ndodh në Bllacë,nuk e di që janë zbulu.

Avni Butyqi - nuk është në cilësinë e politikës dhe nuk jep shifra që nuk janë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 6.

Unanimisht Miratohet

Pika 7 shtesë

Kryesuesi - pasi nuk ka diskutim e hedh në votim pikën shtesë.

**4 për,3 kundër
Miratohet pika shtesë**

Takimi përfundoi: 14:10

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj